



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTORI

Nr. 108 Prot.

Tiranë, më 2401.2024

URDHËR

Nr. 12, DATË 2401/2024

MBI

**“KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE DHE SHKËMBIMIN E DOKUMENTIT
ELEKTRONIK”**

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Çdo dokument elektronik, i dërguar prej institucioneve nëpërmjet postës elektronike në adresat zyrtare elektronike të punonjësve të Universitetit të Arteve, duhet të kërkohet të lëshohet prej tyre edhe në versionin *hard-copy*.
2. Koha e mbërritjes së dokumentit në version *hard-copy* nga institucioni përgjegjës nuk përbën pengesë për Universitetin e Arteve, si institucionin kërkues, që të vijojë procedurat e trajtimit të dokumentit të administruar elektronikisht.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Dekanatet e Fakulteteve, Drejtorët e Drejtorive si dhe Përgjegjësit e Sektorëve në Universitetin e Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot ÇAUSHI

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE